



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1815 / Prot.

Tiranë, më 11.03.2024

**Lënda:** Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin.

**BASHKISË** Korçë

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të nenit 15, ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", urdhrit nr. 97, datë 08.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi 2024-2025, nga programet "Arsimi Bazë", "Arsimi i Mesëm" dhe programi "Për Sportin", për infrastrukturën shkollore e sportive", ju bëjmë me dije se jeni shpallur fitues për projektin/ projektet bashkëlidhur.

Konform legjislacionit të sipërcituar si dhe bazuar në:

1. Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014, i ndryshuar, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
2. Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
3. Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje, kolaudim".
4. Vendimin nr. 319, datë 12.04.2017, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", i ndryshuar.
5. Vendimin nr.216, datë 13.04.2023, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".
6. Vendimin nr.537, datë 08.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave".
7. Vendimin nr.26, datë 15.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara".
8. Vendimin nr.887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike".

Pas miratimit të çeljes së fondeve nga Ministria e Financave, bashkia duhet të fillojë procedurat për realizimin dhe përmbushjen në afat të detyrimeve dhe pas realizimit të procedurave të prokurimit një kopje e kontratës së nënshkruar duhet të përcillet zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSMINISTRI

NINA GUGA



Nr.	Bashkia	Programi Buxhetor	Emërtimi i Projektit	Vlera e Plotë e Projektit	Financim nga NJQV	Financimi nga MAS 2024	Financimi nga MAS 2025
1	Korce	9120	Rikonstrukcion shkolles 9-vjecare "Sevasti Qirjazi", Korce	71,241,573	14,248,315	16,000,000	40,993,258
				71,241,573	14,248,315	16,000,000	40,993,258